



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

Datë: 17.03.2025
Numër Protokolli: 2410/2025

A.nr.85/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.85/2025, të datës 14.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.T., kundër Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.85/2025, e datës 14.01.2025, e parashtruar nga ankuesi A.T.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi i datës 13.01.2025, lidhur me shpalljen e kandidatit të suksesshëm, për pozitën “*Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja*”, sipas Konkursit me numër reference RN00015637.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, A.T., (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 14.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 151 të regjistruar nën shenjën A.nr.85/2025 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015637. për pozitën e punës “

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 30.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa kjo e fundit, më datë 05.02.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për

vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 185/2025 të parashtruar nga ankuesi më datë 14.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;; ; Konkursin me numër reference RN00015637 të datës 29.10.2024; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 13.01.2025 për kandidatin fitues; Lista e renditjes përfundimtar i datës 10.01.2025; Akt Emërimet e anëtareve të komisionit të pranimit; Formularët e Vlerësimit individual të intervistës më goje nga anëtarët e komisionit të pranimit; Njoftimin e datës 30.12.2025; Njoftimin e datës 12.12.2025; Aplikacionin e ankuesit A.T. të datës 26.11.2024 së bashku me dokumentet e bashkangjitura të aplikimit; Aplikacionin e kandidates fituese V.H i datës 05.11.2024 të bashkangjitur me gjitha dokumentet e aplikimit..

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, me datë 14.01.2025, është e pa bazuar, **sepse**:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 29.10.2024 ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00015637, gjegjësisht pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja*”, ku afati për aplikim ka qenë nga data 30.10.2024 deri më datën 28.11.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punës ka aplikuar edhe ankuesi të cilit me njoftimin e datës 12.12.2024 i është refuzuar aplikacioni për arsye se aplikacioni është i mangët pasi që keni kualifikim jo adekuat.

Njësia e Burimeve Njerëzore, pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 13.01.2025 ka publikuar Njoftimin , nga i cili njoftim rezulton se kandidati V.H me gjithsejtë 91.2 pikë është shpallur kandidat fitues për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja*”.

Ankuesi i pakënaqur me rezultatin përfundimtar për shkak të refuzimit të aplikacionit sipas njoftimit të datës 12.12.2024 ankuesi pas shpalljes së rezultati përfundimtar më datë 14.01.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor se, procedura e rekrutimit për pozitën përkatëse të punës është zhvilluar përmes shkeljes së ligjit material dhe dispozitave ligjore , dhe këndvështrim me Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil më është refuzuar aplikacioni dhe se ankuesi pretendon se i plotëson kushtet për të vazhduar në këtë procedurë të rekrutimit.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ju referuar legjislacionit në fuqi, konkretisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë nenit 44 ku përcaktohet se: ... 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 9. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatë dhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohet kandidat fitues. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.”, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht: **Nenit 9** ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas

verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publikë që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimi e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, fagen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit, si dhe nenit 10 paragrafi 9, 10 dhe 11 ku përcaktohet se: 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve. Po ashtu, në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me theks të veçantë nenin 4 paragrafi ku përcaktohet se: Paragrafi 5 i nenit 9 të Rregullores bazike ndryshohet si në vijim: Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publikë që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit.

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se pretendimi ankimor i ankuesit se procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me ligjin material dhe rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës për shkak të refuzimit të aplikacionit të tij, nuk qëndron, ngase duke ju referuar shkresave të administruara të lëndës dhe Konkursit me numër RN00015637 i datës 29.10.2024 ku ne piken (3) tre të konkursit kriteret të përgjithshme formale që duhet të përmbushin kandidatët për këtë pozitë ishin **Arsimi i kërkuar**; Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat : Inxhinieri Mjedis/Kimi e Përgjithshme, Biologji, Ekologji, Gjeografi; **Provoje Pune e kërkuar** : se paku (3) vite provoj profesionale, Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi në momentin e aplikimit ka bashkangjitur Diplomën e studimeve themelore të lëshuar nga Universiteti i

Prishtinës -Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë te Mitrovicës ku ankuesi A.T me datën 05.06.1989 kishte përfunduar studimet themelore dhe ka mbaruar Fakultetin e Xehetaris dhe Metalurgjisë dhe ka fituar titullin Inxhinier i Diplomuar i Teknologjisë dhe se diploma e tillë nuk është adekuat dhe nuk është kërkuar ne pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja*” sipas konkursit me nr. RN00015637 i datës 29.10.2024 dhe mënyre te drejte Organi i Punësimit me njoftimin e datës 12.12.2024 ankuesit i është refuzuar aplikacioni për shkak te kualifikimit jo adekuat,

Kolegji Këshillit ka konstatuar se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, ka përmbajtur njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët dhe janë vlerësuar në pajtim me procedurën e përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Rregullores Nr.15/2024 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil dhe Rregullores (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ndërsa nga provat e pranuar nga ankuesi, si dhe organi i punësimit, Kolegji nuk ka mundur të vërtetoi pretendimin ankimor të ankuesit se ka shkelje ne këtë procedure te rekrutimit. Rrjedhimisht ne këtë procedure te rekrutimit vetëm (4) kandidat kane kaluar fazën e vlerësimit paraprak dhe te njëjti i janë nënshtrua testit me shkrim dhe vetëm kandidati fitues e kishte kaluar ne fazën e intervistës me gojë , derisa kandidati i përzgjedhur si fitues në testin me shkrim ka mbledhur (61.2 pikë) duke arritur kështu pragu e kalueshmërisë sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim*, ashtu që për sa më sipër nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se organi përkatës i punësimit në këtë procedurë të rekrutimit nuk e ka marr për bazë parimin e meritës, ngase sipas shkresave të lëndës rezulton se kandidati fitues V.S ka kaluar me sukses testin me shkrim (61.2 pikë) dhe intervistën me gojë (30 pikë) duke mbledhur kështu gjithsejtë (91.2 pikë) të përgjithshme, dhe si rrjedhojë e njëjti ka fituar të drejtën për emërim në pozitën *“Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”*.sipas konkursit me numër reference RN00015637, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rastin e zhvillimit të procedurës se rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit të datës 13.01.2025 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën e punës *“Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”*.me numër reference RN00015637, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratë Publike, Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregullores (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Kështu që, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.85/2025

Ylber FETAHAJ

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, A.T.;*
- *Udhëheqësit të Personelit në MMPHI; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*